



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR

KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR 60, DATË

02.10.2024

“PËR DISA SHTESA DHE PAKËSIME NË VENDIMIN NR 113, DATË 14.12.2023 “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT AFATMESËM 2024-2026 DHE BUXHETIT VJETOR 2024”.

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës 02.10.2024 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur “Për disa shtesa dhe pakësime në Vendimin nr 113, datë 14.12.2023 “Për miratimin e programit afatmesëm 2024-2026 dhe buxhetit vjetor 2024”. Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjin nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, ligjit 79/2017 “Për sportin” i ndryshuar, Vendimin nr 503, datë 1.8.20214 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në vendimin nr 328, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufinjve të pagave të funksionarve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, VKM-në nr 431, datë 19.07.2023 “Për shtypjen e letrave me vlerë”, Udhëzimin nr 09. datë 23.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, “Për një ndryshim në vendimin nr 113, datë 14.12.2023 “Për miratimin e programit afatmesëm 2024-2026 dhe buxhetit vjetor 2024” i ndryshuar.

VENDOSI:

1. Të miratojë shtesën në vendimin nr 113, datë 14.12.2023 “Për miratimin e programit afatmesëm 2024-2026 dhe buxhetit vjetor 2024” sipas aneksit nr 1 bashkëngjitur vendimit
2. Të miratojë ndryshimet në vendimin nr 113, datë 14.12.2023 “Për miratimin e programit afatmesëm 2024-2026 dhe buxhetit vjetor 2024” sipas aneksit nr 2 bashkëngjitur vendimit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT

Merita Isaraj

Sekretar i Këshillit

Etleva Yzo

